



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 4/972  
Datë: 20/12/2018


Këshilli drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në mbledhjen e datës  
20.12.2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Parlamenti studentor t'i tejkaloj te gjitha problemet e brendshme te krijuara edhe pas mbledhjes se fundit te datës 11.12.2018.
- II. Parlamenti studentor duhet të jetë funksional, përgjegjësi e cila i takon kryetarit të Parlamentit studentor dhe secilit anëtarë të PS.
- III. Asnjë vendim, iniciativë apo adresim i kërkesave, ndaj organeve drejtuese të UP-së, në emër të Parlamentit studentor, nuk mund të merret pa vendimin e shumicës absolute të anëtarëve të Parlamentit studentor të mbajtur në mbledhje të rregullt.
- IV. Duke pasur parasysh se mbledhjet e rregullta të PS / KS, duhet të mbahen së paku njëherë në tre (3) muaj (neni 9, paragr. 3) i Rregullores nr.1/64, dt. 20.4.2018, për konstituimin dhe punën e Parlamentit të studentëve dhe Këshillave të studentëve në Universitetin e Prishtinës, edhe kërkesa për mocion eventual për votëbesim ndaj kryesuesit të Parlamentit mund të parashtrohet tre (3) muaj pas mocionit paraprak.
- V. Këshilli drejtues, konstaton se mandatet e anëtarëve të Parlamentit studentor të verifikuara në mbledhjen e Parlamentit studentor të datës 11.12.2018 dhe të monitoruara nga anëtarët e Këshillit drejtues, janë në përputhje me rregulloren në fuqi.
- VI. Organet kompetente, të merren me hetimin e rasteve për shantazhe, kërcënime, apo keqpërdorime eventuale nga anëtarët e Parlamentit studentor.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Këshilli drejtues.

Ky vendim i'u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së,
2. Kryetarit të PS,
3. Organizatave studentore të përfaqësuara në PS,
4. Menaxhmentit të UP-së,



Këshilli drejtues i UP-së,

Mr. Ardiana Bunjaku, kryesuese